



## PROCESVERBAL VII/2023

**I mbajtur me rastin e mbledhjes së 7 (shtatë) për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Suharekës**

---

Vendi: Suharekë  
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës  
Data: 28.07.2023  
Ora: 10.00

---

### Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci  
Z.Selman Kolgeci  
Z. Flamur Bytyçi  
Z. Urim Suka  
Z. Kushtrim Kuçi  
Znj. Elmaze Bytyqi  
Znj. Bulëza Kuçi  
Znj.Doruntina Zenelaj  
Z.Alban Berisha  
Z. Bexhet Kuçi  
Z. Reshat Selimaj  
Z. Lirim Qatani  
Z. Aziz Bytyqi  
Znj.Sanie Kuçi-  
Rexhepaj  
Znj.Fidaije Kukaj  
Znj.Jehona Rrafshi

Znj. Afërdita Morina  
Z. Vullnet Luzhnica  
Z. Xhevshet Gashi  
Z.Edon Sadikaj  
Znj.Saranda  
Bajraktari  
Znj.Mimoza Bajraktari  
Znj.Festë Kabashi  
Z.Dardan Berisha  
Z.Bajram Basha  
Znj.Mevlude Kabashi  
Znj.Sheqerije Zyrapi  
Znj.Laureta Tafaj  
Z.Liridon Fandaj  
Z.Qëndrim Elshani  
Z.Herolind Limaj

### Të pranishëm të tjerë

Kryetari i Komunës  
Media dhe qytetarë  
OSCE, LMT, KDI  
Znj.Habibe Bytyqi  
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

***REND DITE***

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullore për ndarjen e subvencioneve ;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ti ndihmuar klubit të futbollit “Ballkani” me seli në Suharekë;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2022 të barten për shfrytëzim në vitin fiskal 2023;**
- 5. Shqyrtimi i raportit financiar i administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar - qershor 2023;**
- 6. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2022;**
- 7. Informatë për aktivitetet e KKSBB-së për periudhën janar - qershor 2023;**
- 8. Pyetje dhe përgjigje;**

**Kryesuesi** -e hedh në votim rendin e ditës.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 1.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 2. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullore për ndarjen e subvencioneve ;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Alban Berisha** - kisha pas dëshirë të ishte edhe Drejtoresha e Kulturës në seanë të na jepte sqarime ose dikush nga ekzekutivi,se pse ka ardhë dhe si?Te dokumentet të cilat duhet të dorëzohen gjatë aplikimit,shpesh nëpër raportet e auditorit e kam pa që u cek edhe mungesa e vërtetimit të ATK-së dhe nuk po e shoh këtu. A është e domosdoshme mu kanë ,sepse më duket që është e mangët.

**Avni Bytyqi** - me kërkesë të Drejtorisë së Kulturës është inicua procedura për plotësim-ndryshimin e rregullores për ndarjen e subvencioneve e cila ka qenë e vitit 2013.Në kuadër të rregullores së vitit 2013 nuk kanë qenë të parapara,edhe çështja e monitorimit dhe kthimit të raporteve kthyesë si dhe çështja e transparencës,ashtu siq e kërkojnë edhe udhëzimet administrative.Ne sipas kërkesës së drejtorisë kemi inkorporu këto çështje në kuadër të kësaj rregullore me qëllim që të jetë sa ma funksionale dhe sa ma transparente. Pyetja që the, që në kuadër të rregullores nuk është e paraparë çështja e tatimit të ATK-së,ne në nenin 8 paragrafin 4 e kemi parapara pikën 4.9 edhe dokumentet tjera që i kërkon Drejtoria e Kulturës

sipas nevojës. Thjeshtë ne e kemi lënë këtë në diskrecionin e Drejtorisë së Kulturës që me kërkim edhe dokumentin shtesë të ATK-së.

**Alban Berisha** - a është e obligueshme mu kanë edhe vërtetimi i ATK-së?

**Avni Bytyqi** - qëllimisht, nëse me ligj nuk është e rregullune të çështja e subvencioneve se a kërkohet dokumenti i ATK-së, e kemi lënë në diskrecion të Drejtorisë së Kulturës kur e shesh të nevojshme dhe të arsyeshme me kërkim.

**Alban Berisha** - e kam ndërmend me votu dhe para se me aprovu dua të pyes edhe një herë. A është e precizune qartë në ligjin prej të cilit derivon kjo? A kërkohet dokumenti i ATK-së apo është opsionale?

**Avni Bytyqi** - ky është propozim dhe ende nuk e ka marrë fuqinë ligjore dhe nëse ju si anëtarë të Kuvendit e shihni të arsyeshme dhe të domosdoshme të futen edhe elemente tjera shtesë, në i fusim.

**Urim Suka** - ky dokument që Albani po kërkon, unë mendoj që është edhe në bazë të ligjit sepse i besoj asaj që thotë Albani dhe përtej asaj, unë mendoj që ne duhet me vendos patjetër për faktin që muja me lanë hapsirën për me konkuru dikush që ndoshta s'ka hiq të regjistruar atje në ATK dhe pse me ja dhënë dikuj që s'ka biznes të lajmëruar. Unë them, që ajo që tha Albani me qenë pjesë e këtij dokumentit para se me miratu.

**Kryetari** - asnjë shoqatë nuk mund të merr mjete mbi 1.000€ pa vërtetimin e ATK-së. Përcillni edhe konkurset sepse kjo është edhe publike.

**Shefket Kolgeci** - neni 15 B 3 thotë: monitorimi sipas paragrafit 2 mund të bëhet në perudhën kohore brenda tri vite nga data e përfitimit të subvencioneve. Unë mendoj që janë shumë tre vite dhe le të jetë një vit monitorimi. Nëse më përkrahni, unë mendoj që është më mirë.

**Avni Bytyqi** - ne si komision e kemi prurë si propozim dhe nëse ju mendoni që afati i monitorimit duhet të jetë më i shkurt se tri vjet ne e shkurtojmë sepse ju keni me votu.

**Saranda Bajraktari** - edhe unë pajtohem me Albanin, që vendimi i ATK-së duhet me qenë obligativ dhe jo opsional. Mendoj që është rregullore edhe e subvencionimit që e ushtron edhe Ministria e Kulturës.

**Liridon Fandaj** - ato që thotë Kryetari që nuk mund me marrë kërkush subvencione, vitin e kaluar kanë marrë subvencione pa e dorëzuar vërtetimin e ATK-së. Pasi janë marrë subvencionet, iu është kërkim me qu vërtetimin e ATK-së. Nëse e lëmë opsionale, mund të ndodhë prap ajo që ka ndodhë vitin e kaluar.

**Avni Bytyqi** - atëherë, te neni 4 pika 9 të kërkohet dëshmi dhe vërtetimi i ATK-së. Te monitorimi tre vjeçar, a jeni të pajtimit me shkurtu afatin?

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 2 me ndryshimin që të futet edhe vërtetimi i ATK-së.

**25 për, 1 kundër, 2 apstenime**  
**Miratohet pika 2**

**Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për ti ndihmuar klubit të futbollit "Ballkani" me seli në Suharekë;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Shefket Kolgeci** - kam pyetje për zyrtarin ligjor. Çfarë statute kanë klubet: Ballkani, Ylli dhe klubi i volejbollit? A kanë statut privat, publiko-privat, apo vetëm publik?

**Avni Bytyqi** - të gjitha klubet sportive të cilat e kanë statusin e OJQ-së, ato subvencionohen vetëm atëherë kur Komuna bën thirrje publike duke iu nënshtruar të gjitha procedurave dhe kriterëve që i parasheh rregullorja 04/2017 mbi standartet dhe kriteret për subvencionimin e OJQ-ve me paratë publike, ndërsa klubet sportive të cilat e kanë statusin privat dhe në këtë rast është Ballkani atëherë nuk i nënshtrohet atyre procedurave sipas rregullores 04/2017 por lihet në kompetencën dhe diskrecionin e Komunës që ti propozon Kuvendit dhe Kuvendi të merr vendim me subvencionu apo jo një klub që është privat.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - i kisha lut të gjithë anëtarët, që krenarinë dhe tifozllëkun ndaj klubit ta lëmë në stadium dhe në ulëset tona të diskutojmë mbi arsyeshmërinë e këtij projekt-vendimi. Për mendimin tim nuk ka arsye me u subvencionu në kaq vlerë. Jo që nuk e meriton klubi por mundësitë buxhetore të Komunës nuk janë të mjaftueshme për me iu dediku komplet një klubi sportiv duke i lënë anash të gjithë

klubet e tjera dhe sportistë të tjerë të cilët vërtetë e meritojnë me i stimulë për me arrit suksese në drejtimet që i kanë. Mendoj që Komuna dhe Kuvendi duhet të kenë një qëndrim. A jemi duke e mbajtur qëndrimin si mbështetës të klubeve sportive apo jemi duke e mbajtur qëndrimin si shpërblyes të klubeve për arritjet që i kanë? Nëse jemi duke e mbajtur si shpërblyes, ndoshta edhe ka sens ky projekt-vendim por nëse jemi mbështetës atëherë duhet me i mbështet në mënyrë proporcionale të gjithë sportistët dhe klubet e tjera. Vlera 200.000€ në peridhë tre vjeqare, jemi duke e subvencionu klubin vetëm se kemi mundësi ligjore. Kemi mundësi ligjore edhe tjetër me i subvencionu por s'kemi mundësi buxhetore për shkak se i kemi dediku komplet vetëm një klubi. Për mua nuk ka arsytim dhe s'ka votë ime qëndron kundër. Arsyeshmëria e kërkesës që e ka dërgu klubi është për fazën përgaditore por që garat veq kanë fillu. Njëjtë ka qenë edhe vitin e kaluar. A janë kanë në Turqi me u parapërgadit?

**Urim Suka** - shumicën e rasteve që tha Sania, është një qëndrim përafërsisht i arsyeshëm. Unë në KPF i kam dhënë arsyetimet e mia. Mua klubi i Ballkanit më bënë krenar për gjithë sukset që i ka arrit dhe jo vetëm mua por edhe si LDK jemi krenar dhe mirënjohës deri në pafundësi për gjithë ato suksese që ka arrit. Mirëpo përtej krenarisë që kemi, në këtu jemi për të marrë vendime përafërsisht të barabarta për të gjithë. Kritika që kemi bënë vitin e kaluar edhe sot është e njëjta. Unë po du që vendimet që ne i marrim mos mu kanë tepër të favorshme për dikan dhe mos mu kanë krejt zero për dikan tjetër. Në KPF unë pata bërë një propozim dhe dua ta shpalos edhe këtu. Unë si Urim ia jap 200.000 Ballkanit dhe s'ka çmim ajo çka ka bërë Ballkani por çështja është se ne duhet me i trajtu barabartë. Ne është mirë si Kuvend me marrë një vendim i cili i shpërblen të gjitha klubet për rezultatet e arritura brenda një viti mbi bazën e nivelit të garave. Kjo stimulon klubet me arrit të bëhen kampion, bënë njëfarë barabarzie dhe nuk ka paradox. Lene këtë mënyrë të çasjes që e kemi gabim dhe ta bëjmë një vendim të përbashkët që i trajton të gjithë barabartë dhe le të vlen prej sivjet. Mënyra se si ju po punoni është gabim dhe po na qitni në lajthitje.

**Kryetari** - kush po thotë që s'jemi duke i subvencionu klubet tjera por është një rang, një kategori. Këto janë mjetet e fundit që i lëshohen Ballkanit sepse s'kemi mundësi edhe me dasht. Klubi i Yllit është subvencionu me 25.000 dhe klubet e volejbollit me nga 15.000.

**Urim Suka** - është për keqardhje Kryetar. Ose nuk më dëgjove ose nuk më kuptove. Nuk je tu kuptu asnjëherë dhe për atë po vim në këto situata me diskutu për tema të caktuara. Unë nuk thashë që këta po i subvencionojmë e ata jo. Unë thashë: ta marrim një vendim, edhe vitin e ardhshëm nëse shpallet kampion le ti takon shpërblimi.

**Reshat Selimaj** - unë dua të ndërlihem me Urimin. Është paradox me krahasu Ballkanin me klubet tjera dhe sukseset e tij. Ne ndër vite kemi subvencionu klube dhe sukseset kanë qenë zero. Unë ndihem krenar sa here që ne e kemi subvencionu këtë klub. Sukseset po shihen.

**Aziz Bytyqi** - ne praktikisht jemi para një kërkesë konkrete të një klubi konkret dhe nuk di pse po zgjerohet çështja e trajtimit në mënyrë të barabartë me klubet tjera. Kemi një kërkesë dhe po e shqyrtojmë ku edhe rezultatet e Ballkanit janë të dukshme, të prekshme dhe të gjithë i mbështesim por dikush i mbështet me fjalë e dikush me veprime. Është në dorën tonë dhe s'kemi nevojë me bo krahasime me klube tjera. Kur të vijne kërkesat tjera, i shqyrtojmë.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 3.

**14 për, 12 kundër  
Miratohet pika 3**

**Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2022 të barten për shfrytëzim në vitin fiskal 2023;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Fadil Hoxha** - ZKF jep sqarime dhe thotë që vlera e bartjes së të hyrave vetanake 2021 dhe 2022 është 917,179.21€. Ky vendim kur është aprovu nën 9 pika 6 e kanë precizu që të hyrat vetanake të vitit 2021 që kanë mbet pa u shpenzuar nuk mund të barten nga Komunitat por do të barten në buxhetin e Republikës së Kosovës. Ne kemi qenë të detyruar me bo vetëm bartjen e të hyrave vetanake të vitit 2022. Ato të hyra që janë aprovu në maj, na ka ardhë edhe një shkresë tjetër me 18 korrik. Dje dhe pardje Drejtori i

Financave për buxhet ka organizu një takim me organizatat buxhetore me Komunat ku na është thënë që të bëhen me një vendim. Te viti 2021 të hyrat vetanake kanë mbet kështu: për mallra dhe shërbime 1,978.24, komunalitet janë 2,945.44, subvencione janë 100 dhe kapitale janë 425,020.39 që në total janë 430,044.07 € të pa shpenzuara të vitit 2021 dhe kur i shtojmë 487,135.14 të viti 2022 që nuk janë shpenzu, totali është 917,179.21€. Për mos me shku dhe një here në gusht dhe me bo veq vendimin, unë i kam përfshi të gjitha të hyrat vetanake të viti 2021 dhe 2022 me një vendim. Është në dorën tuaj që ta lini në vendimin e 2022-tës apo doni ta bëni edhe pjesën e 2021-tës me një vendim të përbashkët.

**Urim Suka** - para vetes kam dy dokumente që kanë ardhë për Asamble dhe pak më kanë kriju huti se cilën me trajtu fillimisht sepse njëra ka ardhë sot. Kjo është çasja se sa serioz jeni ju. Planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më herët dhe bartja bëhet në shkurt dhe mars. Ne jemi në fund të korrikut dhe ende nuk e kemi kry planifikimin. Nuk e di a kemi të gjithë të qartë se çka do me thënë bartje. Bartje do të thotë: paret që i kanë mbet pa shpenzu për vitet e tjera. Ato paret që ky Kryetar na thojke po iu mbesin ka qekaq. Sot me vendimet e tij, në fund të korrikut ka ardhë me i ri destinu 917.000€ që i kanë mbet pa shpenzu për vitin 2021. Për vitin 2022 nuk ka qenë i aftë me i shpenzu këto paret dhe sot detyrohet mi bartë prej atyre viteve në vitin 2023. Ne një herë e kemi miratu një bartje të mjeteve por ka dal që ajo nuk u bë sipas procedurave dhe ligjit dhe iu ka kthi Ministria dhe ne po detyrohemi prap me bë. Kur jemi te shpërndarja e mjeteve, është një shpërndarje e keqe, planifikim i keq dhe është qasje që ky pushtet ose duhet me ndërru ose është tu degradu secilën ditë e më tepër.

**Selman Kolgeci** - ndërtimi i rrugëve "Rexhep Velia-seg, Molika, Shalajanët-seg, Kovaqi, Tafa, Jetush Shala, Haxhi Shania etj në Mushtisht. Për këtë rrugë në formularin B 53 të raportit të kontratave për vitin 2022, kjo rrugë figuron që është e kryer, me pranim teknik e krejt. Ku jeni tu dasht mi qu këto paret? Po ashtu te instalimi dhe sanimi i ndriçimeve publike keni planifikim me i kthi 148,774.78€. Në kontratën që komuna ka me operatorin ekonomikë, kontrata është 190.000€. Në të njëjtin formular të raportit të kontratave të vitit 2022 thotë që janë 185.273 € të shpenzuara. Ku jeni tu dasht mi qu edhe 148.000?

**Kryetari** - unë nuk besoj që ka asambleist që nuk e din çka është bartja. Unë nuk besoj që nuk e din Asambleisti që muajin nëntor-dhjetor të hyrat nuk shpenzohen por ato barten. Te të hyrat e vitit 2021 kanë qenë problem në gjithë Kosovën dhe e dini sa është debatuar në parlament të Kosovës. Te ndriçimi e kemi një kontratë afërsisht 2 milion euro. Kontrata është 10 vjeqare. Është duke u bë plani dinamik dhe në moment që kryhet fillojnë komplet ndryshimin e ndriçimit në të gjitha fshatrat e Komunës së Suharekës. Te rruga "Rexhep Velia" është një kontratë zyrtare me vlerë 109.000€ dhe punimet këtë vit po kryhen me këtë kontratë.

**Selman Kolgeci** - po thotë që nuk ka asambleist që nuk e din çka është bartja. Edhe unë nuk po besoj që ka zyrtarë komunal, drejtor a Kryetar që e kërkon me bartë mjete me një projekt që është i kryer. Te ndriçimi, ti i ke lyp mjetet me i kthi në atë emër të projektit, mandej te raporti i auditimit i ke 100 shkelje dhe prap po do me u kthi atje. Ajo kontratë e investimit në energji me eficiency, ajo kontratë besoj që ka me qenë ters për ty. Ti e din çfarë çmimi ke nënshkru Kryetar dhe as në Gjermani nuk i ke këto çmime. Mendoj që atë kontratë duhet me analizu ose me ri-negociu ose me prish.

**Kryetari** - nuk është një burimore. Ka qenë në konkurs në aspektin ligjor, çdo gjë e ka plotësuar. Përgjegjësin e marrim ne për çdo gjë.

**Selman Kolgeci** - raporti i auditorit për vitin 2022 ka thënë disa here që I ke tejkalu edhe listen e projekteve që ka nxjerr Asambleja. Sa mjete I ka nda Asambleja për këtë kontratë? Të ka thë që ke pagu prej fondeve tjera në kontrat tjera dhe prap ke vazhdu. Merre kqyri çfarë kontrate ke nënshkru dhe me çfarë çmimi.

**Urim Suka** - bartja e mjeteve është si pasojë e mos shpenzimit të buxhetit dhe me u pas shpenzu ato mjete, as Ministria s'ta kish marrë vendimin për me ti nal ato. Bartjen e di që çdo vit kemi me por e theksoj bartjen për faktin se ky e ka theksu bartjen kundër neve për 300.000€.

**Aziz Bytyqi** - bëhet fjalë për bartjen e mjeteve nga 2021-2022 në 2023 dhe u sqarua shumë mirë që nuk e kemi pas të lejuar 2021-shin deri tash dhe tash ka ardhë një vendim me një rekomandim, që me një vendim të përfshihen dy vitet dhe të barten. Tendencë që m'i keqinterpretu senet në mënyrë të qëllimshme quhet spekulim. Në mënyrë absolute po mundoheni me spekulu por ne duhet të jemi të sinqertë. Të hyrat

vetanake nëntor-dhjetor që grumbullohen, nuk ka mundësi me u shpenzu menjëherë dhe barten prej vitit në vit. Tash është mundësia me i ri-dizajnu dhe me i shpenzu në të mirë të qytetarëve.

**Liridon Fandaj** - pasi rrjedh prej fushës së ekonomisë, e kuptoj që tre mujori i fundit edhe nuk mund të shozenohet. Dua ti them kolegut, që këto nuk janë vetëm të tre mujorit të fundit por janë edhe tepri që kanë mbetë suficit i vitit të kaluar dhe po barten në projekte. Në projektet kapitale, a janë të planifikune mirë këto bartje sepse mos po i tejkalojmë atë sa kemi planifikue për atë projekt dhe prap me u kthyer ky projekt-vendim.

**Fadil Hoxha** - e kemi pas kohën shumë shkurtë për me i definu a janë të sakta. Besoj që janë shumë të sakta. Nuk jemi vetëm në organizata buxhetore e jona që kemi probleme. ZKF tutje jep sqarime.

**Urim Suka** - përkundër respektit që kam për të, shefi juaj dul dhe tha që këto që po thoni ju janë spekulime. Le të tregojë se ku janë spekulimet. Unë jam tu e lexu atë që ju e keni prurë. 917.000 janë të juajat që ju i keni prurë për mi bartë ne. Kjo punë është dashtë të kryhet në shkurt.

**Aziz Bytyqi** - spekulimi qëndron në faktin kur ti e din një ngjarje qysh është reale dhe e keqinterpreton në mënyrë të qëllimshme për me spekuluar opinionin publik, m'ia servu diçka që s'është reale. Ti spekulon tu kthyer në fushatën e 2017-tës.

**Shefket Kolgeci** - bartja e mjeteve ka ekzistuar gjithmonë dhe ka me ekzistuar por pse po barten ato mjete? Të ishin kanë mjetet e 2022, shumë normale ka qenë me i bartë në 2023-tën. Pse nuk i hargjove mjetet e 2021-tës në 2022-tën. Qëllimi jonë është me i tregu qytetarëve që kjo qeveria është e paaftë me i harxhu mjetet ku duhet. E vërteta është kjo.

**Kryetari** - në vitin 2021 s'janë shpenzu dhe janë bartë. Qeveria nuk ka lejuar vetëm Suharekën por gjitha komunat. Po thua që mjetet e viti 2022 barten për 2023-tën, por edhe në atë punë jemi duke e bërë.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 4 që mjetet e pa shpenzuara të viti 2021 dhe 2022 të barten për shpenzim në vitin 2023.

**19 për, 6 kundër, 3 apstenime**  
**Miratohet pika 4**

#### **Pika 5. Shqyrtimi i raportit financiar i administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar - qershor 2023;**

**Kryesuesi** - e hap debatin për këtë pikë.

**Selman Kolgeci** - jam në dijeni për kërkesat eventuale të cilat mund të kenë ndodhur gjatë muajve që i lam pas por rezultati i shpenzimeve buxhetore në investime kapitale është dekorajues. Është tregues i qartë i një papërgjegjësie e tregues i një qeverisjeje pa përvojë e pa vizion. Për 6 muaj i kemi shpenzu vetëm 8.14%. Shpenzoni 40% për 6 muaj dhe n'fund s'kemi nevojë me ardhë me bërë debat. Çka doni me bo në fund të vitit dhe si keni me i shpenzu këto mjete? A kemi me pas prap akrobacione të llojllojshme vetëm për me e shpenzu buxhetin dhe me i rreziku zyrtarët të cilët nënshkruajnë edhe nën presion për diçka që në teren nuk është? Nga 49 kontrata të nënshkruara mes autoritetit kontraktues Komuna Suharekës dhe operatorëve ekonomikë për vitin 2023, ju keni arritur ti shpenzoni vetëm 8.19% të buxhetit për investime kapitale. Keni ngecje edhe në shpenzim të buxhetit edhe në zhvillimin e procedurave të prokurimit. Rast i dështimit të procedurave të prokurimit janë dy nga shumë procedurat e prokurimit. Bëhet fjalë për ndërtimin e sallës sportive në Sallagrazhdë dhe në Mohlan. Pavarësisht shpenzimit shumë të ulët të buxhetit në investime kapitale, për nevojat të juaja, ju ishit kujdes shumë mirë për mos m'u tregu dorështrëngues. 8.013€ telefon, 11,727.90€ dreka zyrtare, 16,809.93 keni raportu që i keni shpenzu në shërbime intelektuale dhe këshilldhënëse. Kush janë këta këshilltar intelektual që po iu mësojnë kaq mirë? Kërkoj nga i tërë kabineti qeveritar i Kryetarit që të rritet aktiviteti dhe të zhvillohen procedurat e prokurimit sipas afateve të parapara. Të kryhen investimet e të mos prolongohen punimet, e tani në dhjetor të shohim që po ndodhin punime jo cilësore vetëm sa për me u shpenzu buxheti.

**Urim Suka** - secili prej nesh kemi shqyrtuar materialin dhe ne si opozitë kemi analizu detajet e shpenzimit të buxhetit që ju keni bërë gjatë periudhës janar-qershor 2023. Çka të shqyrtoj unë, ku buxheti për investime kapitale është shpenzuar vetëm 8%. Kjo mënyrë e shpenzimit të parasë publike tregon për

paftësinë tuaj qeverisëse dhe rrjedhimisht kjo mënyrë e shpenzimeve të buxhetit rrit mundësinë e keqpërdorimeve dhe ul ndjeshëm cilësinë e punimeve. Dukuri kjo, që është duke iu përcjell në vazhdimsi. Unë sot do të doja të flisja për projektin e Shtëpisë së Kulturës por ju keni shpenzu vetëm 6% të buxhetit për 6 muaj ndërsa keni 6 vjet qeverisje dhe shtëpia e Kulturës ka mbet si gërmadhë. Unë sot do të doja të flisja për stadiumin e qytetit që Kryetari premtonte në media vitin e kaluar por ju keni shpenzu vetëm 8% të buxhetit për investime kapitale dhe premtimi ka mbet vetëm deklaratë mediale dhe asgjë më shumë. Sot do të doja të flisja për projektin e Kolektorit në rrugën "Skënderbeu" por ju keni shpenzu vetëm 8% të buxhetit ndërsa punimet nuk kanë filluar ende në këtë projekt edhe pse ka dy vite që ju planifikoni buxhet për këtë projekt. Unë sot do të doja të flisja për projektin e mbikalimit të Hisarit por ju keni shpenzu vetëm 8% të buxhetit ndërsa projekti i mbikalimit të Hisarit me vlerë mbi 400.000€ ka një kohë që është ndërprerë. Nuk po listoj dështime të tjera se ka shumë mirëpo përmes këtij zëri opozitar dua të bëj me dije secilin qytetar se gjendja në teren është në kundërshtim të thellë me propagandën që shpërfaq ky pushtet çdo ditë. Andaj duhet qasje tjetër më serioze, më e përgjegjshme, llogaridhënëse. Duhet shpenzim i buxhetit në mënyrë racionale duke shpërndarë rrjedhën e parasë nëpër secilin muaj. Uroj që raporti i nëntëmujorit të ketë përqindje tjera edhe pse dyshoj që ju krejt buxhetin e koncentroni në tre muajt e fundit. Kjo është ajo që ju po punoni keq dhe s' doni me ndëgju për me ndryshu.

#### **Pika 6. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2022;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Doruntina Zenelaj** - sot para vetes kemi një raport shumë të rëndësishëm që na jep një pasqyrë shumë të qartë për Komunën tonë. Për vitin 2022 auditori ka gjetur rreth 17 gjetje: mungesa e projektit ekzekutiv, mos raportimi me kohë mbi koston e subvencioneve të dhëna, vonesa në ekzekutimin e pagesave të faturave, pagesa të projekteve nga buxheti i projekteve të tjera, vonesa në realizimin e projekteve, pagesa përmes vendimeve gjyqësore-përmbartimore, zotim i mjeteve jo sipas rregullave financiare, mungesa e dëshmive për realizimin e punëve shtesë, mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë, tejkalimi i kontratës publike kornizë, mos regjistrimi i plotë i pasurive jo kapitale, mos raportim i komisionit për inventarizim, mos nënshkrimi i planit të menaxhimit të kontratës nga palët kontraktuese, lidhja e kontratës pa përmbushur kriteret e dosjes së tenderit, realizim i aktiviteteve jasht planit të prokurimit dhe mos njoftim i AQP-së, mos plotësimi i formularit për vlerësimin e aplikacioneve sipas poenave, mangësi për dhënie në shfrytëzim të pronave komunale dhe mbivlerësimi i llogarive të arkëtueshme. Në faqe 4 tek bazat për konkluzion, me analizu totalin e këtyre, arrin vlerën mbi 1.300.000. Në faqe 8 tek mungesa e projektit ekzekutiv keni bërë punë pa projekte gjë e cila rezulton se ju keni bërë punë jo cilësore dhe po shihet çdo ditë e më shumë. Në faqe 9, tek vonesat e ekzekutimit të pagesave të faturave thuhet se është bërë për shkak të mos funksionimit të kontrollit të brendshëm gjë që Kryetari nuk e dëshiron të ketë një kontroll të brendshëm të mirëfilltë si dhe vonesa e pagesave të faturave ndikon direkt tek dëmtimi i buxhetit të komunës me kosto shtesë. Në faqe 9 tek pagesa e projekteve nga buxheti i projekteve tjera, ju keni bërë pagesë 15.000€ prej investimeve kapitale për asfaltimin e rrugës magjistrale Suharekë-Prizren dhe çuditërisht këto para janë shfrytëzuar për qëllim tjetër dhe bien ndesh me kundërshtimin e ligjit të buxhetit të cilin e keni bërë pa miratimin e Kuvendit Komunal dhe Ministrisë së Financave. Në faqe 12 tek mungesa e dëshmive për realizimin e punëve shtesë, ju keni bërë pagesë 83 punonjësve që kanë punuar jasht orarit të punës dhe gjatë vikendeve të muajit tetor-nëntor 2022, me shumë prej 11.000€, pa dëshmi se sa orë kanë punuar, në cilat ditë apo data. Dhe këtu vërtetohet se ju nuk keni kontroll të brendshëm por po veproni sipas qejfit tuaj dhe kë doni ta shpërbleni. Shpresoj mos t'ju keni hyrë në hak punëtorëve që me të vërtetë kanë punu. Në faqe 15 tek mos nënshkrimi i planit menaxhimit të kontratës nga palët kontraktuese është gjetur se në 4 kontrata në vlerë mbi gjysëm milionit planet e menaxhimit të kontratës nuk ishin nënshkruar nga palët kontraktuese dhe se menaxheri i kontratës nuk e kishte vlerësuar të nevojshme nënshkrimin e kontratës. Këtu dalim në konkluzion se mosnënshkrimi është bërë qëllimisht dhe me vetëdije të plotë sepse edhe kontratat më të thjeshta nuk lihen pa nënshkruar. Në faqe 20 tek mbivlerësimi i llogarive të arkëtueshme, rezulton se një pronë e

paluajtshme e cila ishte në pronësi të institucionit fetar, ishte vendosur tatim n'pronë me vlerë 6.160€ në vit dhe se kjo ka qenë një pakujdesi në faturim sipas zyrtarëve të Komunës. Në bazë të të gjeturave të këtij raporti vim në një përfundim se Kryetari është duke mos dashur të krijojë një kontroll të brendshëm, duke bërë shkelje të ligjeve, duke dëmtuar buxhetin e Komunës tonë me vetëdije, pasi edhe për të gjitha gjetjet ishte pajtuar duke mos kundërshtuar .

**Laureta Tafaj** - pasi raporti i auditorit është i njejtë dhe fjalët e mija për afërsisht janë të njejtë me parafolësen mirëpo për hirë të transparencës dhe korrektësisë së qytetarëve të Komunës së Therandës duhet me ju tregu për keq menaxhimin e parasë publike që po ndodh me këtë pushtet. Raporti i auditorit për vitin 2022 rezulton me 17 rekomandime prej të cilave 12 janë rekomandime të reja, tre janë të përsëritura e dy pjesërisht të përsëritura. Çështja e parë është mungesa e projektit ekzekutiv, ndërtimi i kanalizimeve në vlerë 261.327€, ndërtimi i rrugëve lokale në Mushtisht 72.213€, objekti sportiv në vlerë prej 69.789€, rregullimi i lumenjëve në vlerë 46.990€. Për këto projekte kapitale nuk është përgaditur projekt ekzekutiv por Komuna kishte inicuar procedurat e prokurimit duke përgaditur vetëm paramasat me arsyetimin që procedurat e prokurimit të mos vonohen. Çështja e dytë është mos raportimi me kohë mbi kostot e subvencioneve të dhëna. Të dashur qytetarë, me datën 09.08.2022 një OJQ paska marrë 25.000€ edhe pse nuk e ka dorëzuar me kohë raportin përkatës financiar që sipas auditorit do të thotë keq menaxhim i buxhetit. Çështja e tertë është vonesa në ekzekutimin e pagesave të faturave ku sipas nenit 39.1 të ligjit 03 L/048 çdo faturë e vlefshme dhe kërkesa për pagesë duhet të kryhet brenda 30 ditëve në të kundërtën faturat e paguara me vonesë rrezikojnë që të shkaktojnë shpenzime shtesë dhe Komuna nuk i ka paguar tre fatura në vlerë prej 30.000€. Pagesa të projekteve nga buxheti i projekteve të tjera. Zakonisht Kryetari del e thotë që m'kanë mbet pare dhe e shtrova atë rrugë dhe këtu po del që është e kundërligjshme. Me e bë një gjë të tillë e sidomos pa miratimin e Asamblesë, për të cilët i lus organet e drejtësisë dhe hetuesisë me pa këtë rast dhe me bo punën e tyre.

**Urim Suka** - raporti i auditimit është një raport i rrugull që zyra kombëtare e auditimit bën për secilën Komunë, rrjedhimisht edhe për Komunën tonë. Sot jemi mbledhur për të diskutuar jo për gjetjet tona por për gjetjet e një organi i cili është mbi ne dhe i pavarur. Dua të theksoj se gjendja në teren është shumëfish më e keqe se sa paraqitet në këtë raport. Në këtë raport janë pasqyruar 17 gjetje ku janë dhënë 17 rekomandime, madje tre nga rekomandimet janë përsëritje e gjetjeve të vitit të kaluar që do të thotë se përkundër vërejtjeve që janë dhënë vitin e kaluar, ju tre prej tyre i keni përsërit. Gjetja e parë e këtij raporti ka të bëjë me mungesën e projekteve ekzekutive. Sipas raportit të auditimit në katër projekte kapitale nuk është përgaditur projekt ekzekutiv por Komuna kishte inicuar procedurat e tenderimit vetëm me paramasë dhe parallogari. Auditorët kanë gjetur vetëm katër raste por siq e dimë ne e siq e dini edhe ju, pothuajse të gjitha projektet tuaja kanë mungesë të projekteve ekzekutive. Gjendja është më shqetësuese për faktin që në këtë raport thuhet që projekti për rrugët në fshatin Mushtisht nuk ka pasur projekt ekzekutiv por e vërteta është që rrugët që ishin në kontratë për fshatin Mushtisht nuk janë shtruar fare gjatë vitit 2022, madje këto rrugë ju i keni shpall në tender sivjet. Gjetja e dytë është mos raportimi me kohë mbi koston e subvencioneve të dhëna. Ju keni dhënë subvencione mirëpo përfituesit nuk kanë sjell raport financiar për shpenzimet e bëra. Mungesa e këtyre raporteve është e çuditshme dhe mund të rezultoj në keq menaxhim të fondeve publike dhe dështim në arritjen e objektivave komunale për çka janë dhënë këto fonde. A janë implementu ato projekte që keni financu apo jo? Pra, është e çuditshme dhe e papranueshme kjo qasje e tillë e shpenzimit të parasë publike, kjo dukuri është edhe më shqetësuese sepse është përsëritje e vitit të kaluar. Një gjetje tjetër është mos plotësimi i formularit për vlerësimin e aplikacioneve sipas poenave. Ju keni nda Subvencione për OJQ të caktuara duke mos plotësuar formular për vlerësimin e aplikacioneve. Madje sipas auditorit ju nuk keni mbajtur procesverbal se si keni ardhur deri tek përzgjedhja e përfituesve të subvencioneve nga Komuna. Gjithëashtu sipas raportit të auditorit Drejtoria për Kulturë nuk e ka bërë sipas rregullave edhe shpalljen publike, duke bërë shpalljen për 13 ditë kalendarike e jo për 15 siq duhet të ishte. Vetëm te subvencionet gjithë këto shkelje ligjore. Dhe kur jemi tek subvencionet, jemi duke fol për plotë 678.129€. Gjetje tjetër është vonesa në ekzekutimin pagesave të faturave. Sipas nenit 39.1 të ligjit nr.03 L 048, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë duhet të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës. Auditorët kanë identifikuar tri mostra të tilla por gjendja është shumë më e keqe.



Lidhur me këtë unë kam kërkuar një raport nga Drejtori i DKA-së për faturat e pa paguara të shkollave për vitin 2022 të cilin raport nuk e kam marrë kurrë. Gjetje tjetër është pagesa e projekteve nga buxheti i projekteve tjera. Kjo është një gjetje që ne e kemi adresuar në vazhdimsi sepse është një dukuri masive e viteve të fundit. Siq e kemi thënë edhe ne, projektet miratohen në Kuvendin e Komunës dhe ri alokimi është kompetencë e Kuvendit të Komunës. Gjetje tjetër është vonesa në realizimin e projekteve. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit dhe sipas nenit 81 të ligjit për prokurim publik, menaxherët e kontratës janë përgjegjës për përmbushjen e kontratës sipas termave e afateve të paracaktuara me kontratë. Auditorët kanë specifikuar 6 raste ku Komuna nuk ka realizuar punimet sipas planit dinamik. Në mesin e tyre është përmendur edhe projekti për ndërtimin e rrugëve në fshatin Samadraxhë të cilën çështje e kam ngritur edhe unë më parë. Sipas auditorëve mosrealizimi i projekteve sipas kushteve të kontratës ndikon që Komuna të mos arrijë objektiva të paracaktuara si dhe mund të shkaktoj vështirësi buxhetore për vitet tjera. Gjetje tjetër është mungesa e dëshmive për realizimin e punëve shtesë. Sipas raportit të auditorit ju keni bërë pagesa për punë shtesë për 83 punëtor pa dëshmi të cilat dëshmojnë se në cilën datë ose orë kanë punuar. Gjetje tjetër mjaft shqetësuese është tejkalimi i kontratës publike kornizë. Gjithnjë sipas raportit të auditorit, ky pushtet me 13.10.2021 ka lidhur kontratë publike për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale në vlerën prej 108.913€ ndërsa për realizimin e kësaj kontrate Komuna ka tejkaluar vlerën për 25.152€. Të dashur qytetarë, çudia e këtij tejkalimi është në faktin që dimri që shkoi ishte pothuaj se pa borë fare. Nuk po kuptoj pse është dashur të dilet mbi planifikimin e bërë. Cila ishte nevoja e këtij tejkalimi? Në këtë raport nuk po figurojnë rrugët në Peqan, Mohlan, Mushtisht Greiqec, Javor, Nishor e shumë vendbanime tjera. Në këtë raport nuk po figuron që për projektin e Kolektort në rrugën "Skënderbeu" për vitin 2022 figurojnë që janë shpenzuar mbi 400.000€ por puna s'ka fillu fare. E shumë devijime tjera e shkelje të ligjit duke anashkaluar vendimet e Asamblesë. E gjithë kjo kritikë nuk është thjesht opozitë por është thirrje me zë të lartë për ju e secilin person përgjegjës që të merren masa e të ndalohet kjo logjikë e mbrapshtë qeverisëse. Ky zë është përmbushje e mandatit qytetar për të cilin jemi votu nga qytetrët tonë. Nuk është asgjë personale siq po provoni me personalizim shpesh por janë fakte konkrete për të cilat ju jeni përgjegjës dhe në një shtet ligjor do të duhej të jepni llogari. Dëmi që po bëni është më i madh prandaj edhe kritika jonë është më e madhe. Dua të bëj një thirrje publike për secilin person përgjegjës për gjithë këto shkelje që po adresohen nga ne e që sot i ka adresu edhe raporti i auditimit, që të fillojnë të shohin, analizojnë e adresojnë këto shkelje. Jo thjesht për ti denuar disa politikan e për të ardhur disa të tjerë por për të pengu këtë logjikë të mbrapshtë qeverisëse e cila po degradon çdo vlerë në qytetin tonë të vlerave.

**Selman Kolgeci** - sa i përket raportit të auditorit, çështja me rëndësi që duhet me theksu është se z. Muharraj duhet me pranuar që paaftësia e qeverisë tuaj tashmë po pasqyrohet në dokumentet zyrtare për dy here radhazi sa unë kam arrit me pa në Asamble dhe për këtë duhet të jeni më të ndërgjegjshëm e më të ndërgjegjshëm para një opinionit të tillë. Siq u tha, ky raport i ka nxjerr 17 rekomandime, 12 të reja, 3 të përsëritura dhe dy pjesërisht të përsëritura. Këto të gjetura, ky rezultat e ky keqmenaxhim i shprehur në këtë raport ka të bëjë vetëm me lëndët të cilat janë punu si mostra por nëse kishin marrë ma shumë mostra, kishin gjetë edhe më shumë. Po e filloj nga tema të cilën e kemi trajtuar disa here e kemi kërkuar që të planifikohet e të projektohet për secilin investim kapital por ju planifikimin e projektimit po e shihni si formë e cila i ndal keqpërdorimet e që këtu pajtohem edhe unë që i ndal keqpërdorimet por përpos kësaj investimet në projekte bëhen më standarte për dallim nga ajo çfarë jemi mësuar të shohim nga qeverisja juaj. Pra, investime qesharake që shumë shpesh janë bë objekt i talljes nga të gjithë. Kjo është forma se si i keni shpenzuar paratë publike. Po bëhet fjalë për çështjen B1- mungesa e projekteve ku në katër kontrata të testuara u tha por asnjëra prej tyre nuk ka qenë në mirëmbajtje. Vlera e këtyre kontratave është afër gjysmë milioni. Kjo është papërgjegjësi dhe ndikon negativisht në investime kapitale që në të ardhmen do të jenë objekte çoftë institucionale e çoftë të infrastruktures e që me vetëdije nuk po i kushtoni rëndësinë që e kërkojnë dhe nuk po i jepni trajtimin që e meritojnë. Në përgjigjen për këtë çështje keni thënë se keni ndërmarrë një veprim të tillë me qëllim që të mos shkaktohen vonesa. Pra, ju po e dini saktë që edhe këtë vit kemi me përsërit të njejtin gabim. Ju kërkoj që mos me bë. Po e përmbyllim muajin korrik dhe akoma jemi shumë larg nënshkrimit të kontratës për hartimin e projekteve, kontratë që edhe pas nënshkrimit nuk do të jetë gjithpërfshirëse sepse në paramasën e saj nuk janë planifikuar një sërë

objektsh që qeverisja juaj i ka prezantuar këtij Kuvendi në KAB 2024-2026. Tek çështja A1 nuk është vetëm ky rast që nga buxheti i një projekti paguani projekte tjera. Kur ne e kemi ngrit këtë shqetësim se si po i paguani projektet pa marrë miratim nga Kuvendi e si po e devijoni listen e projekteve kapitale, ju z. Muharremaj jeni arsyetuar se jeni këshilluar me një ish ministër e me një ish Kryeministër. Po më habit fakti se te përgjigjet që i keni dhënë auditorëve, kur jeni pajtuar me këtë shkelje, nuk paskeni thënë që për këto çështje jeni konsultuar me një ish Ministër të Financave e me një ish Kryeministër. Te çështja A3, meqenëse nga DKA nuk e kemi mësuar asnjëherë këtë shifër, është dasht me prit raportin e auditorit për me na tregu që 176.324€ janë pagesë vetëm për procedurat përmbartimore. Pra, prej 972.282€, shifra 176.324 është vetëm për shpenzimet e përmbartuesve. Tek çështja A7 për mosnënshkrimin e planit të menaxhimit u tha që prej 4 projekteve të marra si mostra, 1.394.096€ janë ekzekutuar pa plan të menaxhimit të kontratës. Pa u përcaktu koha e fillimit dhe përfundimit të punëve, pa u përcaktu afatet e pagesave, pa u përcaktu as menaxheri dhe as mbikqyrësi i drejtëpërdrejtë, pa u përcaktu edhe shumë kushte tjera që janë obligative sipas ligjit të prokurimit publik e që i nxjerr komisioni rregullativ i prokurimit publik. Çështja A8 - lidhja e kontratës pa i përmbush kriteret e kontratës. Për zyrën e prokurimit në Suharekë, pavarësisht gjetjeve, më së miri na flet një ilustrim tjetër në faqen e OSHP-së që si pasojë e ndikimeve dhe mungesës së profesionalizmit, Komuna jonë vazhdon të qëndrojë në top 10-shen e autoriteteve kontraktuese ndaj të cilave ushtrohet e drejta e ankesës nga operatorët ekonomikë. Për kundër kësaj, ju bashkëpartiakun tuaj, menaxherin aktual, keni vazhduar ta favorizoni me një konkurs për menaxher të prokurimit. E keni vlerësuar me pikë maksimale për performancë zyrtarin i cili është përgjegjës për këto dështime dhe zyrtarin i cili i ka dy vërejtje për punën e tij në këtë zyrë prej OSHP-së dhe prej KRPP-së. Ato që u trajtuan më lartë e shumë fakte tjera janë dëshmi e paaftësisë së kësaj qeverije siq nuk e meritojnë qytetarët këtë qeverisje. Z. Muharremaj, këto që po përmban ky raport, i demantojnë e zhveshin prej popullizmit ato fotografitë tua të famshme.

**Kryetari** - faleminderit për kritikë. Përfundimi i opinionit është shumë i mirë dhe kjo është me rëndësi. Rekomandime ka me pas çdo herë. Disa përmirësohen, disa ndryshohen, disa dalin të reja dhe mos brengoseni për këtë. Jemi të hapur ndaj të gjitha institucioneve të Republikës së Kosovës, i respektojmë dhe jemi duke punu. Është bërë plani i veprimit për rekomandime dhe lus drejtorat që secili që ka marrë rekomandimet e veta, të përgjigjen. Një kontratë kornizë e dini sa kemi të drejtë me shtu. Projektet kryesore që kryhen në Suharekë dhe nëpër fshatra, rrugë 50 m dhe 100 m, nuk kemi pas projekte dhe s'kemi mundësi me bo projekte. Përndryshe, të gjitha projektet e mëdhaja që janë me vlera të mëdha kanë projekte. Opinioni e kemi të mirë dhe pretendojmë me i marrë 1.5 milion euro. Ushqimet janë një kategori dhe është mirë me shiku se sa shpenzohet për qerdhe të fëmijëve, pastaj kemi edhe delegacione nganjëherë. Po e shoh që thuhet që Komuna ka shpenzu 2.000€ telefon por aty janë mbi 50 të përfshin dhe është me ligj e paraparë.

**Selman Kolgeci** - replikon Kryetarin. Është e vërtetë që raporti nuk ka ardhë i keq por rekomandimet kanë ardhë të qija.

**Urim Suka** - replikon Kryetarin. Pse e ke tejkalu kontratën për mirëmbajtje dimërore të rrugëve ku borë s'ke pas hiq?

**Kryetari** - kontrata kornizë është e paraparë me ligj dhe ai që e ka nënshkru jep përgjegje. Auditimi është kry për vitin e kaluar dhe ti po flet për këtë dimër që shkoi. Për këtë dimër që shkoi, vitin e ardhshëm kryhet auditimi. Unë jam i kënaqur me vendimin që ka marrë auditori i jashtëm. Jam në gjendje për çdo rekomandim, nëse kemi bërë shkelje ligjore me u përgjigj para ligjit.

**Liridon Fandaj** - kam një pyetje për Kryetarin. Çka nënkupton me konkluzionin e pajtueshmërisë?

**Kryetari** - I kemi pesë lloje të auditimit. Nuk ka dalë më i miri. Prej 38 Komunave, shumë pak komuna e kanë këtë auditim sivjet.

**Liridon Fandaj** - unë të pyeta për konkluzionin e pajtueshmërisë dhe jo se çfarë opinione ka auditimi.

**Alban Berisha** - e pranoj që nuk e kuptoj shumë mirë raportin, sidomos te financat por e pashë që ka gjetje. Për çdo kritikë që po bëjmë ne, ju thoni mos boni politikë. Po du me ditë, a ka bo auditori politikë këtu? Detyrë dhe obligim i joni është me thane atë që e mendojmë dhe nuk mendoj që mas çdo fjale që themi, duhet m'u etiketu që mos bëni politikë. Nëse s'jemi ne këtu me bo politikë dhe me kry këtë punë,

atëherë të rekomandoj Kryesues që deri në zgjedhjet tjera me konstitu,Asamblenë tjetër e mbajmë një mbledhje e që i bje çdo katër vjet.Ju lus ta heqni prej fjalorit fjalën: mos bëni politikë.

### **Pika 7. Informatë për aktivitetet e KKSB-së për periudhën janar - qershor 2023;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin

**Bulëza Kuçi** - në këtë informatë nga KKSB-ja,sipas informatës që na keni dhënë neve dhe duke krahasuar me planin e punës që posedojmë për periudhën janar-dhjetor,në takimin e parë në muajin shkurt nuk është diskutu për pikën 4 të planit të punës,që është mbështetja e projekteve konkrete në zgjedhjen e problemeve të Sigurisë në Bashkësi.Në takimin e dytë nuk është marrë parasysh plani i punës,konkretisht pika për mungesën e trotuareve dhe shenjave sinjalizuese.Pika e tretë e muajit shkurt thotë: organizimi i trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënësit në shkolla.Në kuadër të kësaj pike thuhet që FSK-ja do ti trajnoj nxënësit.Pyes drejtorin se a do të trajnohen dhe në cilat shkolla e konsideron ai të nevojshme?Në secilin takim keni dal me konkluzione dhe shpresoj që të realizohet çdo sugjerim i dhënë.Pse nuk janë fut në rend dite këto pika?

**Avni Bytyqi** - zyrtari ligjor jep sqarime dhe thotë që dy pikat që ti përmende nuk janë diskutu në KKSB sepse nuk ka pas projekte nga anëtarët e KKSB-së që mund të kontribuojnë në atë çështje dhe pikërisht për atë nuk e kemi fut në kuadër të informatës.Nuk ka pikë që është miratu në Kuvend dhe që nuk futet për diskutim në KKSB por varet a diskutohet dhe a ka projekte konkrete.

**Alban Berisha** - kam një vërejtje të vogël për formuluesin e kësaj informate.Këtu po e shoh që vetëm është vendos si lloj procesverbali dhe jo raport.Nuk duhet të shkruhet analizë sepse e kërkon edhe Prishtina.Ky është dokumet zyrtar dhe duhet të futet institucioni i cili e kërkon.Te përmbajtja kisha pas qef që në informatat tjera kur të vijnë,sidomos anëtarët,të paktën mu kanë pjesë e seancës në rolin e musafirrit ose dëgjuesit sepse i kemi edhe ne disa vërejtje tona.E di që nuk mujna me i dhanë kurrfar obligimi atyre si institucion por të paktën me i ngu edhe rekomandimet tona. Mua si qytetar dhe si prind po më pengon,se pse në këtë raport askund nuk përmendet Substanca të ndaluara narkotike.Asnjë veprim nuk është ndërmarrë për këtë.Po e shoh që pikën për qentë endacak veq paskët fillu me hek dhe nuk është në këtë informatë.Te rekomandimet e sezonit veror tërë kohën është rekomandimi që të rritet vigjilenca.Po e shoh që vigjilenca e policisë,me gjithë respektin dhe pa dasht me kritiku punën e tyre fisnike por në sezon të verës vigjilenca u rrit vetëm në mëngjes te denimet e trafikut në trotuar ku rrezikohet jeta dhe siguria e publike midis qytetit.Ka disa netë që unë nuk e shoh asnjë polic në qendër.Edhe te vendimi i financave tërë kohën ka rritje prej denimeve në trafik.Denimet në trafik janë krejt prej trotuareve.Ne e kemi bërë një shesh Kryetar ku ti krenohesh me sheshin dhe normal,ne po e shfrytëzojmë edhe pse kemi kritikën tona për atë shesh.Sa je duke u kujdes që ai shesh me u shfrytëzu për qëllimin që u nis?Aty më shumë u bë një pistë për reklamimin e kerrave të shtrenjtë dhe të shpejtë.Ana e djathtë e trotuarit nuk është si duhet.Kisha pas dëshir që vigjilenca prej policisë të jetë në orët e mbrëmjes.

**Aziz Bytyqi** - sa i përket sigurisë në bashkësi dua të ndalem te qentë endacak.Është një person që shkon me 10 qen reth e përçark.Duhet ti kërkoni policisë të merren me të sepse ata janë qen të rrezikshëm

**Urim Suka** - ajo që unë e kam në këtë material është tendenca për me kthi komplet gjendjen në pozitive. Aty thuhet që qetësia publike është e qetë dhe gjithëçka në rregull..Ajo që pasqyrohet në këtë raport nuk është në realitet tek qytetarët dhe qytetarë kanë shumë vërejtje për pjesën e zhurmave.Unë mendoj që është mirë ti trajtoni gjërat më seriozisht.

**Shefket Kolgeci** - para disa mbledhjeve i kam propozu Kryetarit që të bëhet një zgjidhje për qentë endacak.Kryetar,unë prap e kam këtë kërkesë.E lexova që Komuna e Mitrovicës e kanë shpall një tender dhe paska mundësi të bëhet edhe në Komunën tonë.Shqetësimet për qentë endacak janë edhe më të mëdhaja siq e thanë edhe kolegët.Merre këtë iniciativ dhe do ta kesh përkrahjen e të gjithëve.Kjo është kërkesë edhe për ju por edhe për komplet qeverinë komunale.

### **Pika 8.Pyetje dhe përgjigje;**

**Selman Kolgeci** - kam një kërkesë për rrugën Sopijë-Vraniq dhe rrugën në Samadraxhë. I keni nënshkru kontratat para dy-tre muajve dhe punimet i keni fillu në kohën kur po vijnë mërgimtarët. Pse është dasht me prit kur të vijnë mërgimtarët dhe jo me fillu me kohë? Punimet po i realizoni me një plan dinamik të përkohshëm dhe mendoj që duhet me bo një plan dinamik të përkohshëm për me aprovu për segmente të caktune. Në kohën kur po zhvillohen punimet nuk keni as plan të menagjimit të trafikut dhe pa ndonjë analizë se ku ka me u intervenu n'sanime para shtresës qarkulluese e të ngjajshme. Këto ditë kam marrë shumë shqetësime nga qytetarët të cilët frekuentojnë rrugën Sopijë-Vraniq-Mushtisht dhe qytetarët të cilët shfrytëzojnë rrugën në Samadraxhë. Kam një kërkesë për Drejtorin e Shërbimeve publike si bartës i projektit që punimet në këto dy rrugë dhe jo vetëm të realizohen me një dinamikë të përsheptuar. Punimet zhvillohen në segmente aq të gjata sa është kapaciteti i kompanive që të përfundoj pjesët ku bëhet heqja e shtresës qarkulluese dhe jo të hapen fronte me kilometra e pastaj të përfundojnë pas disa muajsh. Po investohen mjete financiare në shuma të konsiderueshme në sanimin e kanalizimeve por rezultatet në teren janë shumë të padukshme. Kam marrë shqetësim nga disa banorë në rrugën "Lisat e pajtimit" në Svrovë dhe disa banorë të lagjes Basha në Vraniq për kanalizimet që kanë shpërthyer në afërsi të shpijave të tyre. Savrova dhe Vraniqi iu kanë drejtu kërkesa për sanime por nuk jeni përgjigje. Ju lutem nxirrni në teren ekipe që të dalin ta vizitojnë dhe ti ofrojnë zgjidhje qytetarëve. Është dasht disa reagime publike që ju me ndërmarrë hapa për lirim e rrugës Bukosh-Reqan dhe aty ky intervenim është gjysmak sepse nuk është liru rruga komplet. Kur do të intervenoni në lirim e rrugëve: tranziti-krahu i djathtë (përrreth objektit të Damperit), rruga "Dëshmorëve" nga tregu deri tek rrethrotullimi, rruga "Ndre Mjedja", "Bajram Curri" brenda Komunës si dhe shumë rrugë tjera në shumë fshatra që janë në gjendje të kalueshme por me vështirësi. Seancën e kaluar kemi diskutu për një pusëtë në Gelancë dhe ende është ashtu. Në rrugën "Reshat Muqa" në Vraniq përsëri i njejt qytetar ka ra n'pusëtë, shkak është edhe mos funksionimi i ndriçimit. Nuk është intervenu në ndriçim. Ndriçimi publik në shumicën e lokaliteteve ka dështu. Pse është prish kaq shpejt ndriçimi publik? A ka ofru garancion dikush për këto punë? Drejtor, të lutem merru me çështjen e ndriçimit për shkak se po na derivon probleme edhe me Sigurinë në Bashkësi, me rastet e vjedhjeve. Pyetje për Drejtorin e Bujqësisë: jeni zotu në seancën e kaluar edhe ti edhe Kryetari se keni me shku me kqyr rrugën atje. Janë bujq punëtor dhe ju s'keni shku as me kqyr atë rrugë.

**Enver Shabani** - shumica e pyetjeve dhe komenteve që bëre, qëndrojnë por edhe është e vërtetë që ne jemi në gjashtëmuorin e dytë dhe punët na kanë ngec në teren por nuk është vetëm në fajin tonë. Është e vërtetë që ne si njësi e kërkesës i udhëheqim procedurat e zyrës së prokurimit dhe të gjithë operatorët ekonomikë së fundmi e nënshkruajnë një kontratë me zyrën e prokurimit. Ne si njësi e kërkesave kemi bërë disa herë presione (kërkesa me shkrim-emaile) dhe fatkeqësisht ata shpesh edhe nuk janë përgjigj. Shumica e kontratave janë 90 ditëshe, që e kemi pas problem me sqaru edhe me operatorët ekonomikë se a janë 90 ditë pune apo 90 ditë kalendarike. Është fjala për rrugën në Samadraxhë dhe rruga Sopijë-Vrani, andaj edhe kompanitë kanë bërë gërryerjen e asfaltit ku kanë bë telashe në komunikacion, kanë bë pluhur. Sa i përket pastrimit nga vegjetacioni te Bukoshi, Reqani dhe rrugë të tjera, ne e kemi një kontratë me Ndërmarrjen Publike "Eko Regjion" por edhe ata kanë mungesë të punëtorëve. Sa i përket pusetave e kemi një kontratë të hapur për sanimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve ku në këtë kontest hyjnë edhe pusetat. Kjo kontratë e ka një menaxher dhe jo gjithmonë operatorët janë të ndërgjegjshëm dhe ka pas raste kur vet kemi dal në teren, i kemi sanu dhe me forma të tjera. Sa i përket ndriçimit publik, keni durim deri në dhjetor. Pjesa dërmuese do të sanohet dhe do të jetë ndriçimi i ri dhe me poqe eficiente. Pse janë të dëmtuara ne nuk e dim por edhe pse kanë mirëmbajtje dhe garancion 1 vjeçar. Ata po arsyetohen se ka pas vetëtimat dhe shumica prej tyre nuk kanë rrufepritës dhe mungesa e tyre ka shkakto djegje të atyre dhe për djegje nga rrufeja nuk kanë garancion.

**Kryetari** - Selmani e din që është një plan dinamik, është një kompani jasht Komunës duke e mbikqyr dhe në momentin që vje rekomandimi, unë i marr vendimet sipas rekomandimit. Kontrata është nënshkru mbi një muaj dhe deri tash me pas dasht, ata veq ishin afër. Rastin e njejtë e kemi edhe në fshatin Samadraxhë. Ne kemi problem me Hidro Regjionin dhe me KEK-un. Ata nuk i japin llogari Komunës. Ne mjete ndajmë çdo vit mirëpo aty ku e ka në menaxhim Hodroregjionin, ata përgjigjen edhe për ujë dhe për kanalizim. Procedurat janë kry me kohë por varet krej prej kompanive. Kryetari tutje jep sqarime rreth pyetjeve.

**Ardian Kotorri** - unë jam në strukturat e fshatit Samadraxhë dhe realisht kur ka filluar riasfaltimi i rrugës, ne si struktura të fshatit i kemi bërë një kërkesë Drejtorisë së Shërbimeve Publike për me i ndërpre punimet për shkak se kemi problem me një pjesë të ujit prej qendrës së fshatit deri te rruga që shkon në Njëpërbisht. Drejtoria në atë kohë e ka ndërpre punën dhe u mundu ta bëjë një zgjidhje ndërsa për problemet tjera që kanë rrjedh, nuk mund të flas. Premtimin që e kam dhënë Asamblesë e kaluar, ai premtim vazhdon me qenë. Kam bisedu me fshatarët atje dhe i kam thënë që do të vijmë por ka dal një problem me kompaninë dhe më së largu të hënë do të jemi në Mohlan.

**Kryetari** - pse s'po e përmend Selmani se si u kry Savrova, Vraniqi, Tvorani, Popolani e shumë rrugë tjera. Edhe asaj i vje rendi por ka pas defekt. Drejtor, a ke komunikuar me fshat apo jo?

**Selman Kolgeci** - sot në orën 09:02 kemi bisedu me Elmi Gashin i cili e ka bërë këtë kërkesë dhe ai më ka deklaruar që ju nuk jeni marrë me këtë punë. Kryetar ne nuk dalim me raportin për punët e tua. Jemi tu kërkim prej prillit kur ti vet je zotuar në planin e punës së Kuvendit që ke me dal para Asamblesë me raportin për punët e viti 2022.

**Kryetari** - unë raportoj dy herë në vit para qytetarëve.

**Qëndrim Elshani** - pyetjen e kam parashtrur edhe më shumë se një vit, për qasjen në rrugën kryesore të automjeteve që vijmë prej rrugës "13 Qershori" apo rruga e stadiumit. Përpos që u dëmtu shumë dhe ka gropa, aty këmbësorët nuk po mundin me ec por as automjetet nuk mund të ecin si duhet. Keni thënë që edhe ndriçimin keni me rregulluar në atë pjesë.

**Visar Kuçi** - edhe ti edhe banorët e lagjes e din që ajo rrugë nuk është për lagje, ajo është vetëm për te stadium. Rruga juaj zyrtare është tjetër.

**Qëndrim Elshani** - cila rrugë është për banorët e lagjes? Ajo që s'mundet me hy automjeti!

**Visar Kuçi** - ajo është parking i stadiumit dhe rrugën lagjja e kanë në pjesën tjetër dhe i di problemet pronësore që i kanë.

**Qëndrim Elshani** - pyetja ime konkrete është: A ka me u rregulluar qasja e asaj rruge brenda këtij mandati sepse është një investim i vogël që e zgjidh një problem të madh.

**Visar Kuçi** - e kanë adresuar disa here banorët por zyrtarisht është parking i stadiumit. Lagjja e ka rrugën tjetër.

**Qëndrim Elshani** - e ka për detyrë Komuna me siguruar rrugën.

**Kryetari** - Drejtori i Pronës duhet të merret me detallet se si është puna dhe të shohim çka do të mund të bëjmë.

**Bulëza Kuçi** - Pyetje për Drejtorin e Arsimit: lus Drejtorin të na njoftoj për mbylljen e vitit shkollor 2022-2023. Si ka shkuar ky vit shkollor? A është e rrezikuar ndonjë shkollë që të mbyllet për vitin 2023-2024? A ka rënie të nxënësve në vitin që shkoi? Drejtori na ka njoftuar që Ministria ka financuar DKA-në me shumë prej 13.000€ që të mbyllet ky vit shkollor me shujtat e nxënësve. A do të vazhdohet ky shërbim edhe në vitin e ardhshëm?

**Remzi Bajselmani** - ne e kemi përmbyllur një vit i cili ka filluar me vështirësi për shkak të grevës që ka qenë por megjithatë viti ka përfunduar suksesshëm pa incidente dhe suksesi është 2% më i lartë se vitin e kaluar, ka numër të mungesave më të theksuar por mund ta quajmë vit të suksesshëm. Ne si Komunë e Suharekës për shkak të numrit të rënies së nxënësve, jemi në proces të mbylljes së tri paraleleve të ndame të shkollave: në Stravuçin nuk kemi asnjë nxënësi, në Vërshhec kemi 4 nxënës dhe në Delloc kemi 8 nxënës prej 5 klasave. Për të gjitha këto ne e kemi bërë planifikimin e sistemimit. Te shujtat e kam thënë që është një vlerë prej 127.000€ për vitin që jemi e deri në dhjetor dhe kemi filluar me realizuar prej prillit. Në kodin ku hyjnë pagesat për ushqim, po hyjnë në kategorinë e drekave zyrtare. Ka dalë që 11.000€ i hargjoi DKA, por janë paguar shujtat e nxënësve 1-5 dhe qerdhet sepse ne nuk kemi organizuar dreka zyrtare asnjëherë.

**Bulëza Kuçi** - ju keni thënë që i ka lëshuar Ministria special për mi paguar shujtat e nxënësve.

**Remzi Bajselmani** - po, kemi thënë që mjetet janë alokuar te DKA për shujtat e nxënësve prej 1-5 dhe pagesën çdo muaj e bën DKA nga ato mjete.

**Bulëza Kuçi** - a është menduar për ata nxënës që të bëhet transporti i tyre në shkollat tjera?

**Remzi Bajselmani** - transportin e tyre e kemi siguruar dhe do të bëhet me buxhet të Komunës.

**Urim Suka** - Pyetje për Drejtorin e Arsimit: ditë më parë kam vizituar shkollën në fshatin Javor dhe atje pash që fusha sportive ishte e mbushur me ujë dhe ishte e papërdorshme. Nga ajo që pashë, u konstatua që

ishite bllokuar drenazhimi i saj.A jeni të informuar me këtë problem dhe a keni planifikuar zgjidhjen e tij? Nëse po, kur pritet të bëhet funksionale kjo fushë? A keni planifikuar të bëni izolimin e shkollës “Shkëndija” sepse siq e kemi diskutu edhe më herët ata kanë probleme të mëdha me të ftoftin gjatë stinës së dimrit. Pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike: Këto ditë kam marrë shqetësime nga banorët e fshatit Sllapuzhan lidhur me mosfunksionimin e ndriçimit publik në këtë fshat. A jeni në dijeni për problemet me ndriçim në fshatin Sllapuzhan dhe kur pritet të funksionalizohet ndriçimi në këtë vendbanim?

**Remzi Bajselmani** - sa i përket fushës sportive në Javor, nuk kam informacion. Janë dy kontrata, njëra për renovime. Kemi parapa që aty të zgjerohet një trotuar në Javor dhe shkallët në hyrje të shkollës do të rregullohen. Për shkollën “Shkëndija” në kuadër të kontratës ne do të rregullojmë disa dysheme, sipas kërkesës së shkollës dhe analizës që është bërë, ndërsa sa i përket izolimit nuk kemi të planifikuar asgjë. Drejtori i shkollës dhe punëtorët që punojnë aty kanë thënë që nuk ka probleme me nxemje.

**Enver Shabani** - informatën e kam marrë dje që edhe në fshatin Sllapuzhan ka problem me ndriçim publik ku një kamion i lartë e ka këput telin e ndriçimit publik. Ne dje kompanisë që e ka fitu tenderin ia kemi bërë një listë me prioritet, duke fillu nga fshati Vraniq, Sopijë, Gelancë, Sllapuzhan e plotë fshatra të tjerë. Drejtori tutje jep sqarime.

**Urim Suka** - duhet patjetër me plotësu pjesën e Drejtorit të Arsimit ku u diskutu për shkollën “Shkëndija”. Unë mendoj që është i njëjti drejtor dhe staf që ka komunikuar ky dhe që kam komunikuar unë. Të gjithë që i kam taku ma kanë paraqit të njëjtin problem. Problemi me të ftoftin është i madh. Në vizitën që kemi qenë, ka qenë edhe Festa. Këtë problem unë e adresova këtu për me i bërë zgjidhje atyre fëmijëve dhe është çështja e parë elementare që duhet me reagu. Mua më çudit përgjigjja e drejtorit. I sugjeroj drejtorit që temat që ngriten, të i trajtojë sa ma seriozisht. Te ndriçimi publik, unë i kam ngrit disa here problemet e Bllacës dhe vazhdon me qenë jashtë funksionit si shumë vendbanime që i kam ngrit. Ndriçimet publike janë problem serioz. Janë duke u dhënë parë dhe nuk është tu shku në vendin e duhur. E di që keni vështirësi por unë po kërkoj prej juve të rritet vëmendje sepse po jepen parë shumë dhe s’po bëhet asgjë.

**Remzi Bajselmani** - kur të doni shkojmë te drejtori i shkollës. Një vit më parë ka pas probleme shkolla me nxemje dhe e kemi ndërru kalldajën, madje ka thënë që bëhet shumë nxehtë.

**Shefket Kolgeci** - pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike: E kam bërë një kërkesë dhe faktikisht ka qenë kërkesë e qytetarëve dhe drejtori nuk e ka realizu. Fjala është te ujëmbledhësi në shesh.

**Enver Shabani** - nuk ka një javë që e kemi salldu. E kemi bisedu me Drejtorin e Urbanizmit dhe duhet me trajtu nga fillimi.

**Liridon Fandaj** - pyetje për Drejtorin e Urbanizmit pasi është në komision për Zonën Industriale. Mbledhjen e kaluar Drejtori i Pronës na njoftoi që 19 kontrata deri tash i kanë shiku. 1. Prej 19 kontratave, sa biznese kanë leje ndërtimi? A i keni verifiku veprimtaritë të cilat i ushtrojnë ato biznese? A ka biznese që në kontratë i shkrun një veprimtari tjetër dhe ushtrojnë një tjetër? 2. Lejet e ndërtimit që janë marrë në Komunën tone nga operatorët, edhe pse në hartat Zonale ajo pjesë parashihet ndërtim por toka është bujqësore. A duhet operatorët me shëndrru prej tokës bujqësore në ndërtimore dhe me kërku leje ndërtimi? Pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike: rruga e fshatit Peqan është renovu vitin e kaluar dhe sot është ma keq se që u kanë vitin e kaluar dhe kanë ndodh tri aksidente. Kam një kërkesë që te rrethrotullimi ku e ndan pjesën e Suharekës me fshatin Peqan, të bëhet një vendkalim për këmbësor.

**Visar Kuçi** - ne po punojmë si komision deri në një raport përfundimtar.

**Liridon Fandaj** - unë të pyeta se sa prej 19 kontratave kanë leje ndërtimi.

**Visar Kuçi** - shumica e bizneseve kanë leje ndërtimore dhe disa prej tyre kanë edhe legalizim. Sa i përket lejeve ndërtimore në toka bujqësore, ne e kemi të miratuar një dokument të miratuar në Asamble dhe në Ministri të linjës të PZHK-së dhe HZK-së.

**Liridon Fandaj** - unë e kam marrë si shqetësim të disa operatorëve ekonomikë. A janë të obliguar me kthi nga toka bujqësore në ndërtimore edhe pse parashihet ndërtimore me HZK?

**Visar Kuçi** - neve nuk na pengon si drejtori sepse aty në qertifikatë i shkrun tokë bujqësore por Drejtoria e Urbanizmit bashkë me Drejtorinë Pronës ka me i shënu në qertifikata ndërkohë se si është destinimi në PZHK. Drejtori tutje jep sqarime.

**Liridon Fandaj** - unë e thashë sepse është shqetësim i operatorit dhe është një postim i Ministrisë së Bujqësisë ku thotë që kërkoj nga institucionet e hetuesisë të verifikojnë pronat që po kthehen nga bujqësore në ndërtimore duke u bazu në HZK.

**Visar Kuçi** - ministri e thotë për ato Komuna që nuk kanë Plan Zhvillimor dhe Hartë Zonale. Drejtori tutje jep sqarime.

**Enver Shabani** - sa i përket sanimit në rrugën Suharekë-Peqan, kontrata është me një operatorë ekonomikë dhe punët janë kry për sanime. Për kualitetin e punës, ai duhet me garantu një vit. Te rrethrotullimi Suharekë-Peqan e kemi një projekt për trotuare dhe parkingje dhe në kuadër të saj e kemi planifiku që të bëhen vijat e bardha aty dhe një trotuar do të zgjatet në anën e djathtë të rrethi.

**Armend Krasniqi** - sa i përket Zonës Industriale, e kam përfundu Z.I. dhe e kam shiku çdo operator ekonomikë me kujdes dhe do të jap rekomandime që ti s'ke guxu me qenë aty dhe me dhënë rekomandim, duke e pas pas dy - tre javëve raportin.

**Liridon Fandaj** - nuk besoj që ti ke me guxu. Aty ka fushë të sportit në një industri me veprimtari industri, ka industri të gomes ku aty ka të mbjellur grur dhe ti në momentin që e ke verifiku është dasht mi thirr inspektorët dhe me ja shkëput kontratën.

**Armend Krasniqi** - zona ka lloje të ndryshme të destinimeve. Ka fusha bujqësore të cilat janë të parapara me ligj.

**Liridon Fandaj** - unë po them me veprimtaritë që janë në kontratë.

**Festë Kabashi** - po ndërlidhem me debatin e z. Suka me Drejtorin e Arsimit. Unë si pjesë e shkollës fillore "Shkëndija", pjesë e kolektivit dhe në kontakt të përditshëm me kolegët dhe me nxënësit, thamë që qëndrojnë të gjitha këto kërkesa dhe nevoja të shkollës. Drejtori propozoi që ta bënim një vizitë të tre që me pa gjendjen reale të shkollës. Kështu s'kish pas nevojë për dilemma se a ka nevojë me u investu apo jo. Me aq sa kam pa, nevojë urgjente janë dyshemetë, ndërrimi dritareve dhe izolimi. Pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike: a keni ndonjë projekt aktiv për rregullimin e kanalizimit në fshatin Krushicë e Poshtme? Ky fshat asnjëherë nuk ka qenë i kyqur në ujësjellës. A keni ndonjë ide ose plan konkret se si do t'mund ta siguronim një burim për ujë të pijshëm për këtë fshat.

**Enver Shabani** - sa i përket ujit, uji nuk na takon neve si Komunë. Na takon me u marrë me çështjen e ujit deri te njehsorët mirëpo tani nuk kemi ndonjë planifikim. Vitin e kaluar e kemi përfundu një pjesë të mirë të kanalizimit në Krushicë kurse pjesën tjetër kemi fillu mirëpo njëri e ka ndërpre punën aty dy vite më pare.

**Festë Kabashi** - si planifikohet që me u kriju zgjidhja?

**Enver Shabani** - ne jemi të gatshëm çdo moment me vazhdu me projektin nëse na vjen zgjidhja nga kryesia e fshatit.

**Festë Kabashi** - tek shtëpitë kushërinjëve të mi, ata ballafaqohen me këtë problem dhe me sa kam informacion ata nuk i kanë këto telashe pronësore dhe ndoshta do të ishte e udhës me bë një vizitë dhe me pa se si po qëndron puna. Edhe unë jam e gatshme me u bashkangjit.

**Enver Shabani** - tregon arsyet se pse po vin këto probleme.

Takimi përfundoi: 13:05

Procesmbajtësja:  
Dafina Haziraj